

2324
03/3



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AVOKATURA E SHTETIT
ZYRA E AVOKATIT TË PËRGJITHSHËM

Nr. 132/2 Prot.

Tiranë, më 05. 3. 2024

Lënda: Kthim përgjigje shkresës tuaj nr. 568/1 prot., datë 28.02.2024, me lëndë: "Mbi ankimin ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare"

KOMISIONERIT PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Adresa: Rr. "Abdi Toptani", Nd. 5, Tiranë

Për dijeni:

QENDRËS "RES PUBLICA"



Adresa: "Blv. Gjergj Fishta", Nd. 24, H. 3, Ap. 7, Tiranë

Në vijim të shkresës tuaj nr. 568/1 prot., datë 28.02.2024 me objekt ankimin ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare, ju bëjmë me dije se sistemi elektronik zyrtar i Avokaturës së Shtetit ka hasur problematika të një natyre teknike dhe për këtë arsye nuk është mundur kthimi i përgjigjes dhe dhënia e informacionit të kërkuar brenda afatit ligjor.

Sa i përket kërkesës për informacion të Qendrës Res Publica drejtuar Avokaturës së Shtetit, lutem gjeni në vijim përgjigjen e përgatitur më herët nga Avokatura e Shtetit brenda afateve ligjore.

Në nenin 5 të ligjit nr. 10018, datë 13.11.2008 "Për Avokaturën e Shtetit", të ndryshuar, parashikohet: 1. Avokatura e Shtetit kryen funksionet e mëposhtme: a) ofron shërbim këshillimor për veprimtarinë juridike të personave juridikë të parashikuar në këtë nen, veçanërisht për lidhjen e kontratave, të cilat parashikojnë efekte financiare për shtetin".

Në nenin 15 të po të njëjtit ligj, paragrafët 1 dhe 4 parashikohet: 1. Avokatura e Shtetit, në mbrojtje të të drejtave dhe të interesave të shtetit, u jep mendim me shkrim organeve të administratës publike, kur kjo i kërkohet prej tyre, në veçanti, për të vënë në lëvizje, për të kundërshtuar ose për të tërhequr çështje në gjykim...4. Këshillimi paraprak i organit përkatës të administratës publike

me Avokaturën e Shtetit është i detyrueshëm për t'u kërkuar, në rastet e mëposhtme: a) për hartimin, negocimin nënshkrimin, ndryshimin dhe zgjidhjen e kontratave të koncesionit, të kontratave të partneritetit publik-privat. Për kontrata të tjera publike për kryerje punimesh, furnizim mallrash dhe furnizim shërbimesh, me vlerë mbi kufirin e ulët monetar, të përcaktuar në legjislacionin në fuqi për prokurimet publike; b) për hartimin, negocimin, nënshkrimin, ndryshimin dhe zgjidhjen e kontratave, të cilat parashikojnë zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në arbitrazh ndërkombëtar; c) kur shfaqen pretendime nga pala private apo institucioni publik në lidhje me përmbushjen e detyrimeve të kontratës, në rast konflikti interpretimesh apo çdo mosmarrëveshje tjetër në ekzekutimin e kontratave që parashikojnë zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në arbitrazh ndërkombëtar; ç) kur shfaqen pretendime nga investitorë të huaj për shkelje nga Republika e Shqipërisë të ligjit, traktateve apo marrëveshjeve ndërkombëtare për mbrojtjen e investimeve të huaja.

Nga ana e Qendrës Res Publica në vijim të një kërkesë të një qytetari në shërbimin online www.publeaks.al është kërkuar informacion nga ana e Avokaturës së Shtetit për rastet që është kërkuar këshillimi i kësaj të fundit nga ana e institucioneve publike për lidhjen, negocimin etj. të kontratave publike, në bazë të nenit 15, pika 4 (a), të ligjit nr. 10018, datë 13.11.2008 "Për Avokaturën e Shtetit", të ndryshuar: a) për hartimin, negocimin nënshkrimin, ndryshimin dhe zgjidhjen e kontratave të koncesionit, të kontratave të partneritetit publik-privat. Për kontrata të tjera publike për kryerje punimesh, furnizim mallrash dhe furnizim shërbimesh, me vlerë mbi kufirin e ulët monetar, të përcaktuar në legjislacionin në fuqi për prokurimet publik".

Në përgjigje të kësaj kërkesë dhe në kuadër të analizës vjetore të punës së Avokaturës së Shtetit për Zyrën e Këshillimit dhe Koordinimit Ndërmnistror, për vitin 2023 rezulton se Avokatura e Shtetit ka dhënë mendim këshillimor për 24 kontrata për lidhjen, negocimin etj. të objekteve të ndryshme, sikurse janë kontratat e parashikuara në nenin 15 të ligjit nr. 10018, datë 13.11.2008 "Për Avokaturën e Shtetit", të ndryshuar.

Gjithashtu, lidhur me kërkesën e Qendrës Res Publica për kopje të dokumenteve lidhur me sa është kërkuar, ju bëjmë me dije se Neni 3 i ligjit nr. 10018, datë 13.11.2008 "Për Avokaturën e Shtetit", i ndryshuar, parashikon se: "Avokatura e Shtetit e ushtron veprimtarinë në bazë të parimeve të profesionalizmit, të efikasitetit, të konfidencialitetit, të unitetit të doktrinës, të përgjegjësisë dhe korrektesisë në zbatimin e legjislacionit në fuqi".

Po ashtu, Neni 15, pika 9 i ligjit nr. 10018, datë 13.11.2008 "Për Avokaturën e Shtetit", i ndryshuar, parashikon se: "Mendimi këshillimor, i dhënë nga Avokatura e Shtetit, sipas dispozitave të këtij ligji, jepet në çdo rast me shkrim, është konfidencial dhe është pjesë përbërëse e praktikës, për të cilën kërkohet këshillimi".

Për sa më sipër, dhënia të tretëve nga ana e Avokaturës së Shtetit, e dokumentacionit që përbën mendim këshillimor për personat juridikë të përcaktuar në nenin 5 të ligjit organik të sipërcituar, do të përbënte shkelje të detyrimit të saj ligjor të konfidencialitetit.

Dokumentacioni mbi çështjet objekt këshillimi, gjendet pranë çdo personi juridik i cili me cilësinë e autoritetit përgjegjës ka kërkuar asistencë juridike nga Avokatura e Shtetit.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

